



# Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

## Albanian National Olympic Committee

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63  
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: [secretariat@nocalbania.org.al](mailto:secretariat@nocalbania.org.al) • <http://www.nocalbania.org.al>

### NJOFTIM PËR POZICIONIN

#### “Menaxher/e i Rrjeteve Sociale”

*Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH) është një organizatë sportive Kombëtare e pavarur, themeluar në vitin 1958, pa qëllim fitimi, e organizuar mbi bazën e parimeve të Kartës Olimpike, dhe që funksionon sipas statutit të saj. KOKSH është organizata e vetme që përfaqëson Lëvizjen Olimpikë Shqiptare, parimet e së cilës janë të detyrueshme për tu zbatuar nga të gjithë anëtarët e saj.*

Në kuadër të Projektit “**Ekipe Sportive 2022**”, projekt i financuar nga Buxheti i Shtetit, KOKSH, fton kandidatët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e punës “**Menaxher/e i Rrjeteve Sociale**”

Objektivi i përgjithshëm i Projektit është krijimi i një Programi Kombëtar që nxit 1) sportin masiv, 2) zbulimin e talenteve, 3) edukatën sportive dhe parimet olimpikë. Projekti do të formojë Ekipe sportive jashtë shkollore në nivelin 9-vjecar (nga klasa e 6 – 9); në nivelin shkollë e mesme (nga klasa 10 – 12); në universitete.

#### **Detyrat e Menaxher/e i Rrjeteve Sociale**

Menaxher/e i Rrjeteve Sociale është përgjegjës për menaxhimin dhe përmbajtjen e rrjeteve sociale të projektit. Ky person do të mbikëqyrë ndërveprimet e platformave sociale të projektit me publikun duke zbatuar strategjitë e përmbajtjes së platformave të mediave sociale si dhe sipas një programacioni të përcaktuar prej tij/saj. Detyra të tjera përfshijnë analizimin e të dhënave të angazhimit online, identifikimin e tendencave në ndërveprimet me audiencës, si dhe planifikimin e fushatave dixhitale për të ndërtuar audiencë në internet. Angazhohet gjatë hartimit, përpilimit, dhe zbatimit të planit të marketingut dhe komunikimit të Projektit. Për të përmbushur objektivat e caktuara Menaxheri/ja i Rrjeteve Sociale duhet të përmbushë këto detyra:



# Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

## Albanian National Olympic Committee

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63  
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: [secretariat@nocalbania.org.al](mailto:secretariat@nocalbania.org.al) • <http://www.nocalbania.org.al>

- Asiston në zhvillimin dhe zbatimin e strategjive të Komunikimit Dixhital të projektit.
- Krijon kontent cilësor sipas një kalendari specifik dhe ndjek përditësimin e tij në kanalet e komunikimit online.
- Kujdeset për relizimin e teksteve, përshtajten e video-ve dhe fotove sipas platformave të ndryshme social si dhe publikimin e tyre.
- Mat efektivitetin e kanaleve të komunikimit sipas audiencës së targetuar.
- Ruan marrëdhënie bashkëpunimi shumë të mira me departamentet e tjera të projektit.
- Synon përmirësimin dhe rritjen e imazhit të projektit.
- Kontribon në krijimin e brand/identitetit të projektit.
- Dizajn sipas përcaktimeve specifike kur është e nevojshme.

### **Kualifikimet dhe Eksperienca:**

- Minimumi një diplomë Bachelor në Financë ose Marketing.
- E preferuar një diplomë Master në fusha të ngjashme.
- Eksperiencë pune 1-2 vjet.
- Njohuri të teknikave të marketingut online.
- Aftësi në zbatimin e aktiviteteve të marketingut.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës Angleze.

### **Aftësi dhe kompetenca kryesore**

- Aftësi ndërpersonale, komunikim profesional verbal dhe të shkruar.
- Aftësi bashkëpunimi dhe ndërveprimi në ekip dhe me drejtuesit.
- Qasje pozitive dhe energjike në punë;
- Orientim ndaj detajeve dhe organizimit të proçeve të punës.



# Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

## Albanian National Olympic Committee

Rr. "Muhamet Gjollesha", Sheshi Mustafa Q. Ataturk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63  
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: [secretariat@nocalbania.org.al](mailto:secretariat@nocalbania.org.al) • <http://www.nocalbania.org.al>

### Procedura e aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentat e aplikimit si më poshtë:

- Curriculum vitae (CV) në formatin Europass;
- Letër Interesi;
- Fotokopje të diplomave universitare;
- Dokumente të tjera mbështetëse (çertifikata të fituara nga trajnime, pjesëmarrje në konferenca, botime, letra reference, etj).

Kandidatët e interesuar duhet t'i dërgojnë dokumentet e aplikimit deri më datë 04 Maj 2022, ora 16.00, në adresën [secretary.general@nocalbania.org.al](mailto:secretary.general@nocalbania.org.al), me subjekt: **Aplikim për pozicionin Menaxher/e i Rrjeteve Sociale "Ekipet Sportive 2022"**

